

**Vendim nr. 12 dat ë 15.01.2025**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryesuese
Sandër Beci,	Anëtar
Illir Toska,	Anëtar

në datën 15.01.2025 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 9 (R) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

**KËRKUES:** **RAKIP SKËNDERI**

**OBJEKTI:** Shfuqizimi i vendimeve nr. 41-2022-3529 (399 SP), datë 15.11.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë; nr. 4, datë 13.01.2023 të Gjykatës së Apelit Korçë; nr. 00-2024-948, datë 23.05.2024 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Kthimi për rigjykim në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë për një hetim më të thelluar, duke përfshirë kryerjen e autopsisë, për të përcaktuar shkakun e vërtetë të vdekjes së Ç.S., si dhe shpalljen fajtorë të stafit mjekësor D.A., M.Dh., dhe A.M.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 18, 43, 44, 55, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “i” dhe 146, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 24 dhe 27 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjo i relatorin e çështjes Ilir Toska, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

## **V Ë R E N:**

### **I**

#### **Rrethanat e çështjes**

1. Kërkuesi Rakip Skënderi është vëllai i shtetasës Ç.S. (*viktima*), e cila në datën 05.07.2020 është shtruar në Spitalin e Sanatoriumit Korçë dhe është ekzaminuar me pneumoni atipike. Në datën 12.07.2020 ajo është transferuar në Reanimacionin e Spitalit Rajonal Korçë, ku në datën 17.07.2020 ka ndërruar jetë.

2. Në datën 23.09.2020, motra e viktimës, shtetasja Z.G., ka depozituar një kallëzim penal ndaj personelit mjekësor të Spitalit Rajonal Korçë, me pretendimin se dyshonin që vdekja e viktimës ishte shkaktuar nga trajtimi mjekësor i gabuar, konkretisht nga heqja e maskës së oksigjenit, vendosja në intubim, zhveshja gjatë mjekimit, etj. Për këtë kallëzim, fillimisht, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë (*Prokuroria Korçë*), me vendimin e datës 29.09.2020, ka vendosur mosfillimin e procedimit penal me arsyetimin se fakti i kallëzuar nuk përmbante elemente të veprës penale. Mbi ankimin e kallëzueses, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, me vendimin nr. 41-2021-166 (19/420 prot.), datë 18.01.2021, ka vendosur shfuqizimin e vendimit të Prokurorisë Korçë për mosfillimin e procedimit penal duke urdhëruar regjistrimin e procedimit për veprën penale “Neglizhenca në trajtimin mjekësor”, të parashikuar nga neni 96 i Kodit Penal (*KP*).

3. Në vijim, Prokuroria Korçë ka regjistruar procedim penal nr. 107 të vitit 2021, për veprën penale të parashikuar nga neni 96, paragrafi 2, i KP-së. Në përfundim të hetimeve paraprake, prokurori i është drejtuar gjykatës, duke kërkuar pushimin e procedimit penal mbi shkakun se fakti nuk përmbante elementet e veprës penale, të parashikuar nga neni 96, paragrafi 2, i KP-së, pasi nuk provohej ekzistenca e veprimeve ose mosveprimeve në kundërshtim me diagnozën e mjekimit. Për këtë kërkesë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë (gjyqtari i seancës paraprake), me vendimin nr. 41-2021-3020 (404 SP), datë 30.09.2021, ka vendosur kthimin e akteve prokurorit dhe urdhëruar atë të kryejë veprime hetimore, konkretisht një ekspertim mjekoligjor, duke përcaktuar edhe çështjet objekt ekspertimi.

4. Në zbatim të vendimit të gjykatës, Prokuroria Korçë ka vijuar hetimet paraprake duke urdhëruar kryerjen e një ekspertimi mjeko-ligjor nga një grup ekspertësh të Institutit të Mjekësisë

Ligjore (IML) dhe administruar aktin përkatës të ekspertimit. Më tej, mbështetur edhe në të dhënat e ekspertimit, prokurori i ka paraqitur sërish gjykatës kërkesë për pushimin e procedimit penal mbi shkakun se nuk ekziston fakti penal i neglizhencës mjekësore. Gjatë shqyrtimit të kësaj kërkesë, ku ka marrë pjesë edhe kallëzuesja me cilësinë e motrës së viktimës, me kërkesën e saj gjykata ka dëgjuar shpjegimet e ekspertëve mjeko-ligjorë në lidhje me aktin e ekspertimit dhe për pyetjet e palëve. Në përfundim, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë (gjyqtari i seancës paraprake), me vendimin nr. 41-2022-3529 (399 SP), datë 15.11.2022, ka vendosur pushimin e procedimit penal, duke arsyetuar se veprimet hetimore janë të plota dhe se nga hetimi nuk provohet ekzistenca e faktit penal të neglizhencës mjekësore. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim motra e viktimës.

5. Gjykata e Apelit Korçë, me vendimin nr. 4, datë 13.01.2023, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë në të njëjtën linjë arsyetimi si ajo. Po kështu, gjykata e apelit u ka dhënë përgjigje pretendimeve të ankueses (motrës së viktimës) në lidhje me mungesën e veprimeve të plota hetimore për sa i përket moskryerjes së autopsisë së viktimës, duke arsyetuar se ky veprim nuk është i nevojshëm dhe, për më tepër, kryerja e tij është e pamundur aktualisht për shkak të dekompozimit tërësisht të trupit të viktimës. Kundër vendimit të gjykatës së apelit ka ushtruar rekurs kërkuesi, në cilësinë e vëllait të viktimës.

6. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-948, datë 23.05.2024, të marrë në dhomën e këshillimit, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit me arsyetimin se ai nuk përmbante asnjë nga shkaqet e parashikuara nga neni 432 i Kodit të Procedurës Penale (KPP).

7. Në datën 14.10.2024, përmes shërbimit postar, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të ligjit nr.8577/2000, është regjistruar në datën 25.11.2024.

## II

### Pretendimet e kërkuesit

8. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar cenimin e së drejtës për një proces të rregull ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, pasi Gjykata e Lartë ka disponuar në dhomën e këshillimit pavarësisht interesit të tij për të marrë pjesë në shqyrtimin e çështjes. Po kështu, Gjykata e Lartë, sikundër edhe gjykatat e faktit, kanë zbatuar gabim ligjin procedural penal, pasi kryerja e autopsisë është mënyra e vetme shkencore për përcaktimin e shkakut të vërtetë të vdekjes së viktimës, ndërkohë që gjykatat, duke arsyetuar se kërkesat për zhvarrosjen dhe kryerjen

e autopsisë nuk janë bërë që në fillim, nuk kanë mbajtur parasysh aspektin njerëzor të situatës dhe tronditjen e familjarëve të viktimës në atë moment.

### III

#### Vlerësimi i Kolegjit

##### A. Për legjitimitimin e kërkuarit

9. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2 të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr.8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të verë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor, që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

10. Në këtë këndvështrim, kërkuari legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi në cilësinë e familjarit të afërt të viktimës (vëllai i së ndjerës) ka qenë palë në procesin gjyqësor ku është vendosur pushimi i çështjes penale të regjistruar në lidhje me ngjarjen e vdekjes së viktimës, proces për të cilin, sikundër edhe për procesin penal në tërësi, ka ngritur pretendime në ankimin kushtetues individual, ndaj, për rrjedhojë, ka interes në çështjen e parashtruar, si viktimë jo e drejtpërdrejtë e shkeljeve të pretenduara gjatë këtij procesi, themeli i të cilit lidhet me të drejtën e jetës, të mbrojtur nga neni 21 i Kushtetutës.

11. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, Kolegji vëren se kërkuari i është drejtuar Gjykatës duke ngritur pretendime për procesin penal në tërësi që është përmbyllur në Gjykatën e Lartë, për të cilin nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese përveç ankimit kushtetues individual, ndaj ai e ka plotësuar edhe këtë kriter.

12. Për sa i takon kriterit paraprak të legjitimitimit *ratione temporis*, bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4 muaj nga konstatimi i cenimit të së drejtës. Në rastet e kundërshtimit të vendimit gjyqësor

të Gjykatës së Lartë, Gjykata e ka llogaritur afatin ligjor 4-mujor, duke filluar nga data në të cilën vendimi i arsyetuar bëhet i disponueshëm për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare ose njoftimit elektronik të tij, në rast se palët kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit (*shih vendimin nr. 42, datë 19.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Në rastin konkret, Kolegji konstaton se procesi gjyqësor ka përfunduar me vendimin e datës 23.05.2024 të Gjykatës së Lartë dhe, sipas informacionit të kësaj të fundit, vendimi është publikuar në faqen zyrtare të saj në datën 28.10.2024, ndërsa ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë në datën 14.10.2024, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

14. Lidhur me legjitimitet *ratione materiae*, kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor me argumentin se Gjykata e Lartë ka disponuar në dhomën e këshillimit pavarësisht interesit të tij për të marrë pjesë në shqyrtimin e çështjes. Po sipas kërkuesit, Gjykata e Lartë, sikundër edhe gjykatat e faktit, kanë zbatuar gabim ligjin procedural penal, pasi kryerja e autopsisë është mënyra e vetme shkencore për përcaktimin e shkakut të vërtetë të vdekjes së viktimës, ndërkohë që gjykatat, duke arsyetuar se kërkesat për zhvarrosjen dhe kryerjen e autopsisë nuk janë bërë që në fillim, nuk kanë mbajtur parasysh aspektin njerëzor të situatës dhe tronditjen e familjarëve të viktimës në atë moment. Referuar argumenteve të parashtruara, në lidhje me cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor, kërkuesi, në thelb, ka ngritur pretendime në drejtim të *së drejtës për t'u dëgjuar* për shkak të formës së gjykimit të çështjes në Gjykatën e Lartë, sikundër edhe për *standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor* nga gjykatat e zakonshme.

15. Për sa i përket pretendimit për cenimin e së drejtës për t'u dëgjuar për shkak të formës së gjykimit të çështjes nga Gjykata e Lartë, Kolegji konstaton se kjo e fundit, në dhomën e këshillimit, ka kryer shqyrtimin paraprak të rekursit të kërkuesit, duke arritur në përfundimin se ai nuk plotëson kriteret e pranueshmërisë për shqyrtim në seancë gjyqësore (mbi bazë të dokumenteve ose me praninë e palëve). Sipas ligjit procedural (neni 433 i KPP-së), shqyrtimi i pranueshmërisë së rekursit bëhet në dhomën e këshillimit, pra pa praninë e palëve. Në këto kushte, shqyrtimi paraprak i rekursit të kërkuesit nga Gjykata e Lartë në dhomën e këshillimit, është bërë sipas formës së gjykimit të përcaktuar nga ligji. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se ky pretendim i kërkuesit nuk mund të merret në shqyrtim.

16. Në lidhje me pretendimin e kërkuesit për cenimin e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor, Kolegji vlerëson se ai *prima facie* bën pjesë në juridiksionin kushtetues, ndaj do të trajtohet në vijim.

*B. Për pretendimin e cenimit të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*

17. Kërkuesi ka pretenduar se gjykatat kanë zbatuar gabim ligjin procedural penal, pasi kryerja e autopsisë është mënyra e vetme shkencore për përcaktimin e shkakut të vërtetë të vdekjes së viktimës, ndërkohë që gjykatat, duke arsyetuar se kërkesat për zhvarrosjen dhe kryerjen e autopsisë nuk janë bërë që në fillim, nuk kanë mbajtur parasysh aspektin njerëzor të situatës dhe tronditjen e familjarëve të viktimës në atë moment.

18. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka pohuar se e drejta për një proces të rregullt ligjor, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës, përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë, funksioni i të cilit është t'u tregojë palëve se ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Zbatimi i këtij parimi është vlerësuar nga Gjykata rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e tyre. Gjykata ka theksuar, gjithashtu, se ky detyrim ndryshon në varësi të rrethanave të çështjes konkrete dhe natyrës së vendimit, dhe se masa e arsytimit varet nga natyra e vendimit në fjalë (*shih vendimet nr. 21, datë 26.09.2022; nr. 6, datë 16.02.2021; nr. 79, datë 14.12.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Lidhur me vendimet e dhëna nga Gjykata e Lartë në dhomën e këshillimit dhe referuar natyrës së gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, Gjykata ka theksuar se vetëm kur janë të pranishme pretendime që kanë të bëjnë me shkeljen e parimeve themelore të procesit gjyqësor, si dhe kur këto pretendime gjejnë pasqyrim në materialet e çështjes, vendimi i dhomës së këshillimit për mospranimin e rekursit vë në dyshim të drejtën për një proces të rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 2, datë 11.02.2021; nr. 27, datë 27.03.2017; nr. 19, datë 19.07.2005 të Gjykatës Kushtetuese*). Shqyrtimi i çështjes nga dhoma e këshillimit e Gjykatës së Lartë nuk është vetëm një konstatim formal i paraqitjes së shkaqeve ligjore në rekurs, por konsiston në vlerësimin e këtyre shkaqeve dhe bazueshmërisë së tyre, duke analizuar materialet e dosjes gjyqësore. Në rast se Kolegji në dhomën e këshillimit krijon bindjen se shkaqet e ngritura në rekurs janë haptazi të pabazuara, pasi nuk bëjnë pjesë në ato që parashikon dispozita ligjore ose nuk gjejnë mbështetje në aktet e dosjes gjyqësore, atëherë është në funksionin e tij të vendosë, në pajtim me kërkesat ligjore, mospranimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore (*shih vendimet nr. 5, datë 09.02.2023; nr. 9, datë 26.03.2018; nr. 12, datë 19.03.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Arsyetimi i kufizuar i vendimeve të dhomës së këshillimit nuk përbën cenim të së drejtës për proces të rregullt ligjor dhe se një arsyetim

i tillë është tregues i faktit që kërkuesi nuk ka ngritur një nga argumentet ligjore të përcaktuara në dispozitën përkatëse të legjislacionit të brendshëm, që është kusht për pranimin e kërkesës (*shih vendimet nr. 16, datë 16.03.2021; nr. 9, datë 26.03.2018; nr.8, datë 26.02.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Nga ana tjetër, Gjykata në mënyrë konstante ka pohuar se interpretimi dhe zbatimi i ligjit është detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm për qëllim të procesit gjyqësor që ato zhvillojnë, ndërsa detyra e saj është të vlerësojë nëse gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese, si dhe nëse zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar ose haptazi i paarsyeshëm. Kjo do të thotë se Gjykata nuk vepron si shkallë e katërt gjykimi dhe për këtë arsye vendimet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm nuk vihen në dyshim, përveç rasteve kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e arsyeshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose i tillë që e bën të padrejtë gjykimin (*shih vendimet nr. 9, datë 27.02.2024; nr. 3, datë 23.02.2016; nr. 42, datë 07.07.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Duke iu kthyer çështjes konkrete, referuar argumenteve të kërkuesit, në thelb, ato kanë të bëjnë me përgjigjen e dhënë nga gjykatat e zakonshme në lidhje me pretendimin e tij për mungesën e veprimeve hetimore të plota për sa i përket moskryerjes së autopsisë së viktimës dhe zbatimit nga ato në këtë mënyrë të ligjit procedural. Nisur nga kjo, Kolegji do të verifikojë nëse gjykatat e zakonshme kanë arsyetuar në lidhje me këtë pretendim të kërkuesit dhe nëse interpretimi nga ato i ligjit, i shprehur përmes arsyetimit të vendimeve, është i paarsyeshëm ose arbitrar.

22. Kolegji konstaton se në datën 23.09.2020 motra e viktimës ka bërë kallëzim penal ndaj personelit mjekësor të Spitalit Rajonal Korçë në lidhje me vdekjen e viktimës në datën 17.07.2020. Pas shfuqizimit nga gjykata të vendimit të prokurorit për mosfillimin e procedimit penal, në janar të vitit 2021, Prokuroria Korçë ka regjistruar procedimin penal për veprën penale “Neglizhenca në trajtimin mjekësor”, të parashikuar nga neni 96, paragrafi 2, i KP-së, në kuadër të të cilit ka kryer disa veprime hetimore, si administrimin e dokumenteve mjekësore, fletës përkatëse të regjistrit të pavijonit të Reanimacionit dhe kartelës klinike të viktimës, ku pasqyrohej personeli dhe trajtimi mjekësor i viktimës. Po kështu, janë marrë deklaratimet e personelit mjekësor, konkretisht nga mjekët pneumologë dhe reanimatorë, të cilët kanë dhënë sqarime në lidhje me trajtimin mjekësor të viktimës. Në analizë të provave të administruara, prokurori ka arritur në përfundimin se fakti nuk përmbante elementet e veprës penale, të parashikuar nga neni 96, paragrafi 2, i KP-së, ndërsa nuk provohej ekzistenca e veprimeve ose mosveprimeve në kundërshtim me diagnozën e mjekimit,

duke kërkuar pushimin e procedimit penal. Kjo kërkesë nuk është pranuar nga gjykata e shkallës së parë (gjyqtari i seancës paraprake), e cila e ka kthyer çështjen për hetime të mëtejshme, duke lënë si detyrë kryerjen e një ekspertimi mjeko-ligjor për të përcaktuar faktin nëse në mjekimin e viktimës ka pasur veprime ose mosveprime që përbëjnë neglizhencë mjekësore në lidhje me përcaktimin e diagnozës dhe nëse janë kryer mjekimet e domosdoshme, si dhe për të përcaktuar shkaku kryesor të vdekjes dhe faktin nëse ky shkak është pasqyruar në kartelën mjekësore.

23. Gjatë vijimit të hetimeve paraprake, në zbatim të vendimit të gjykatës, është realizuar ekspertimi mjeko-ligjor nga një grup ekspertësh, të cilët, referuar dokumentacionit mjekësor, kanë arritur në konkluzionet se: (i) të ndjerës i është dhënë ndihma e nevojshme mjekësore gjatë shtrimit, fillimisht në Senatorium dhe pastaj në Reanimacionin e Spitalin Rajonal Korçë; (ii) diagnoza e të ndjerës është përcaktuar saktë dhe se mjekimi ka qenë në përputhje me diagnozën klinike; (iii) në mungesë të autopsisë, shkak shkencor i vdekjes së të ndjerës nuk mund të përcaktohet saktësisht, por se nga të dhënat e marra nga dokumentacioni mjekësor shkak i vdekjes së saj ka qenë pamjaftueshmëria e funksionit të organeve mushkëri, zemër, veshka në terren në gjendje inflamatore të rëndë virale dhe bakteriale; (iv) për ardhjen e pasojës nuk është bërë shkak neglizhenca mjekësore. Mbështetur edhe në të dhënat e ekspertimit, prokurori ka kërkuar sërish pushimin e procedimit penal mbi shkaku se nuk ekziston fakti penal i neglizhencës mjekësore. Gjatë shqyrtimit të kësaj kërkesë, me kërkesë të motrës së viktimës (kallëzueses), gjykata ka dëgjuar shpjegimet e ekspertëve mjeko-ligjorë në lidhje me aktin e ekspertimit dhe për pyetjet e palëve, mbështetur edhe në të cilat gjykata e shkallës së parë (gjyqtari i seancës paraprake) ka vendosur pushimin e procedimit penal. Ajo gjykatë i ka vlerësuar si të plota veprimet hetimore, duke arritur në të njëjtin përfundim me prokurorin se nga hetimi nuk provohet ekzistenca e faktit penal të neglizhencës mjekësore.

24. Motra e viktimës ka paraqitur ankim kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë (gjyqtarit të seancës paraprake), duke ngritur pretendime në drejtim të plotësisë së veprimeve hetimore, konkretisht për moskryerjen e autopsisë së viktimës, ndërsa ky veprim, sipas ankueses, ka qenë i detyrueshëm dhe përmes të cilit mund të përcaktohej shkak i vërtetë i vdekjes së viktimës. Mbi këtë ankim, gjykata e apelit ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, ku me të njëjtën linjë arsyetimi si ajo, ka arritur në të njëjtat përfundime. Ndërkohë, në përgjigje të pretendimeve në ankim, gjykata e apelit, në interpretim të ligjit nr. 7830, datë 15.06.1994 “Për autopsinë”, ka arritur në përfundimin se autopsia e viktimës, në momentin kur ajo ka ndërruar jetë, nuk është kërkuar as nga shefi i shërbimit/i pavijonit dhe as nga familjarët



e saj, duke mos qenë kështu ajo e detyrueshme në atë rast. Pavarësisht kësaj, sipas asaj gjykate, kryerja e autopsisë mund të shërbente vetëm për përcaktimin e shkakut shkencor të vdekjes së viktimës, ndërkohë që moskryerja e saj në vetvete nuk përbën neglizhencë mjekësore dhe as mund të provojë neglizhencën mjekësore në trajtimin e viktimës. Për më tepër, sipas gjykatës së apelit, referuar dhe mendimit të ekspertëve në gjykim, kryerja e këtij veprimi hetimor tashmë është e pamundur, pasi trupi i viktimës është dekompozuar tërësisht.

25. Për rekursin e kërkuarit, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e tij me arsyetimin se ai nuk përmbante asnjë nga shkaqet e parashikuara nga neni 432 i KPP-së. Sipas atij kolegji, gjykatat e faktit kanë marrë në analizë dhe i kanë dhënë përgjigje të argumentuar pretendimit të kërkuarit, të përsëritur edhe në recurs. Gjykata e apelit, vijon ai, brenda kufijve të shqyrtimit gjyqësor të ankimit ndaj vendimit të gjyqtarit të seancës paraprake, u ka dhënë përgjigje të argumentuar pretendimeve të kërkuarit në lidhje me faktin e kallëzuar, rrethanave në të cilat pretendohet se është kryer vepra penale e neglizhencës mjekësore, sikundër edhe për hetimet konkrete të kryera. Po sipas atij kolegji, pavarësisht pretendimit në lidhje me hetimin e çështjes, duke vënë theksin te kryerja e autopsisë, kërkuari nuk ka argumentuar shkeljet e ligjit nga gjykata e apelit e cila, pasi ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë, ka arritur në përfundimin e drejtë se janë kryer të gjitha veprimet e mundshme hetimore, mbi bazën e të cilave është kërkuar pushimi i procedimit penal.

26. Nga sa më lart, Kolegji verën se gjykatat e zakonshme kanë arsyetuar, në veçanti, pretendimin e kërkuarit për mungesën e veprimeve të plota hetimore për sa i përket moskryerjes së autopsisë së viktimës për përcaktimin e shkakut shkencor të vdekjes së saj. Lidhur me këtë, nga përmbajtja e vendimeve objekt kundërshtimi, Kolegji vë në dukje se këtij pretendimi të kërkuarit i është dhënë përgjigje e hollësishme në veçanti nga gjykata e apelit, ndërsa Gjykata e Lartë e ka vlerësuar të drejtë përfundimin e asaj gjykate se në rastin konkret janë kryer të gjitha veprimet e mundshme hetimore. Nisur nga kjo, rezulton se gjykatat e zakonshme kanë përmbushur detyrimin për arsyetimin e vendimit të tyre, ndërkohë që interpretimi nga ato i ligjit, i shprehur përmes arsyetimit, nuk duket i paarsyeshëm ose arbitrar për sa kohë nuk evidentohet ndonjë gabim ligjor ose faktik i dukshëm. Për pasojë, pretendimi i kërkuarit për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor është haptazi i pabazuar.

27. Në përfundim, Kolegji vlerëson se ankimi kushtetues individual i kërkuarit nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

**PËR KËTO ARSYE,**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

**V E N D O S I:**

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.